

**Vendim nr. 290 datë 27.11.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Marjana Semini, Anëtare

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 20 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** PËRPARIM BRAÇE

**OBJEKTI:** Për vendosjen nga Gjykata Kushtetuese për organin e pushtetit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete nr. 4597 akti, viti 2013 sa i përket pjesës së dytë administrative të objektit të padisë të kërkesit Përparim Braçe kundër personave të interesuar Luan Leka dhe përmbaruesit gjyqësor J.H. të shoqërisë përmbarimore private “E.P.S.A” sh.p.k. dhe drejtoria vendore ASHK-së Tirana-veri, ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.  
Shfuqizimi i vendimeve nr. 9055, datë 22.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 405, datë 30.05.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-926, datë 06.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 18, 33, pika 1, 41, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për

**organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 06.06.1995 kërkuesi Përparim Braçe dhe shtetasi Luan Leka kanë nënshkruar një aktmarrëveshje me objekt themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar për ndërtimin, përshtatjen dhe shfrytëzimin e një hoteli, të ndodhur në rrugën “Muhamet Gjollesha”, Tiranë. Palët, po ashtu, kanë përcaktuar, ndërmjet të tjerash, kontributet e veçanta dhe të përbashkëta, në para dhe në natyrë, të secilit prej tyre, si dhe subjektet të cilave do t’u përkiste pronësia e objektit pas përfundimit të tij.

2. Në datën 04.04.2008 shtetasi Luan Leka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e kërkuetit, palë e paditur në atë gjykim, për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga aktmarrëveshja bazuar në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe në nenet 153, 420 dhe 423 të Kodit Civil (*KC*).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.10095, datë 03.12.2009, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e kërkuetit për të njohur shtetasin Luan Leka pronar të dy kateve të fundit të godinës “hotel” dhe të katit nëntokësor duke u kryer edhe ndryshimet përkatëse në regjistrat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (*ZVRPP*). Kërkuesi e ka ankimuar vendimin dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 760, datë 06.04.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas rekursit të kërkuetit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-513 datë 08.03.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për procesin gjyqësor të sipërcituar, duke parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të disponimit të padisë, së drejtës së mbrojtjes, parimit të paanshmërisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Gjykata, me vendimin nr. 19, datë 22.01.2013, ka vendosur rrëzimin e saj.

5. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të sipërcituara, duke parashtruar pretendime për masën e sigurimit të padisë, bllokimin e pronës, sigurinë juridike dhe se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kishin përcaktuar gabim natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 99, datë 09.05.2014, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

6. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2012-513, datë 08.03.2012, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatë dhe Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 229, datë 17.11.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

7. Pasi vendimi nr. 760, datë 06.04.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë ka marrë formë të prerë, shtetasi Luan Leka i është drejtuar shërbimit përmbarimor privat për të filluar procedurat për ekzekutimin e tij. Përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar ZVRPP-së për të kryer veprimet për regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit Luan Leka, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

8. Nga materialet e dosjes së administruar për shqyrtimin e çështjes rezulton se procedurat për ekzekutimin e vendimit kanë përfunduar në datën 08.06.2011 dhe sipas vërtetimit të pronësisë të datës 06.09.2013 shtetasi Luan Leka është pronar i pasurisë nr. 2/226 zona kadastrale nr. 8250, të ndodhur në rrugën “Muhamet Gjollesha”, Tiranë, të regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 97, datë 06.06.2011. Me konkretisht, i dy kateve të fundit, i gjashti dhe i shtati, si dhe i katit nëntokësor, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> secili kat dhe sipërfaqe 97.7 m<sup>2</sup> kati nëntokësor.

9. Kërkuesi në datën 29.07.2013 i është drejtuar gjykatës duke kundërshtuar veprimet përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor J.A., të shoqërisë përmbarimore private “E.P.S.A” sh.p.k., pasi sipas tij nuk kishte qenë në dijeni të veprimeve përmbarimore dhe se për to kishte marrë dijeni pas shkresës së datës 22.07.2013 të ZVRPP-së, Tiranë.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9055, datë 22.09.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 405, datë 30.05.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 9055, datë 22.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj vendimit kërkuesi ka ushtruar rekurs dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-926, datë

06.03.2024, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

11. Kërkuesi në datën 19.09.2024, sipas shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 25.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

12. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* të drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës së aksesit, pasi*: (i) nuk ka pasur mundësi për të ngritur padi lirisht për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, e caktuar me ligj, kompetente, me trup gjykues profesionist, për të paraqitur kërkesa dhe argumente në mbështetje të padisë me natyrë administrative, si dhe për të paraqitur ankim ndaj vendimeve. Ankesat për vendimet e paligjshme dhe arbitrare të organit administrativ nuk i janë nënshtruar kontrollit të organit gjyqësor kompetent, si gjykata administrative; (ii) gjykata nuk ka pranuar kërkesën për shtimin e objektit të padisë për rivendosjen në posedim të shoqërisë "E.A.C" sh.p.k. si administratore të apartamenteve, me një arsyetim të pabazuar sipas të cilit kërkimi ishte objekt i një gjykimi të veçantë; (iii) gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe arsyetuar pikën e dytë të objektit të padisë, sepse nuk ishte kompetente dhe ka rekomanduar për t'iu drejtuar ZVRPP-së dhe gjykatës administrative. Gjithashtu, janë lënë pa shqyrtuar e arsyetuar edhe dy kërkimet bazë të pikës së parë të objektit të padisë për pavlefshmërinë absolute të urdhrit të ekzekutimit nr. 2918, datë 23.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për pavlefshmërisë së veprimeve (të paligjshme) të kryera nga Luan Leka për vënien në posedim të sendeve. Gjykata e apelit nuk ka trajtuar me vendim të ndërmjetëm disa kërkesa paraprake, të cilat në fakt nuk janë shqyrtuar dhe për to nuk ka asnjë vendim, sikurse ka qenë kërkesa për falsitet të disa dokumenteve të regjistrimit në ZVRPP-në, Tiranë, si dhe përdorimi i dokumenteve të falsifikuara nga Luan Leka; (iv) gjykata e apelit nuk ka disponuar për kërkesat e paraqitura në seancën e parashtrimeve të datës 30.05.2016 për riçeljen e hetimit gjyqësor për shqyrtimin e kërkesave për falsitetin e dokumenteve; (v) afati i ankimit në dispozitivin e vendimit nr. 9055, datë 22.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është përcaktuar 5 ditë

nga shpallja e vendimit dhe jo nga momenti i vendimit të arsyetuar, duke e detyruar kërkuesin për të paraqitur ankim pa pasur vendim të arsyetuar. Ditën kur është bërë i disponueshëm vendimi i arsyetuar është paraqitur akti “shtesë ankimi”, por nuk rezulton të jetë shqyrtuar. Padia ka pasur natyrë të përzierë, pasi nuk ka pasur si kërkim vetëm kundërshtimin e veprimeve përmbarimore dhe përcaktimi i afatit për ankim 5 ditë nga 15 ditë përbën cenim të së drejtës së aksesit; (vi) Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka zhvilluar gjykimin në seancë gjyqësore, por në dhomën e këshillimit, e cila nuk ka në kompetencë shqyrtimin e shkaqeve të rekursit. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve rekursit dhe nuk ka dhënë zgjidhje sipas nenit 485 të KPC-së.

12.1.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj*, pasi për kërkimet që lidheshin me veprime dhe mosveprime të ish-ZVRPP-së, Tiranë, kompetente ishte gjykata administrative. Moskompetenca lëndore shtrihet edhe në atë profesionale, pasi vendimi nr. 9055, datë 22.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është rrjedhojë e mosrespektimit të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme“ të ndryshuar. Gjykata e Apelit Tiranë nuk e ka shqyrtuar kërkimin e dytë të padisë, duke rekomanduar paraqitjen e një padie të re kundër ish-ZVRPP-së. Për rrjedhojë, *është cenuar edhe e drejta për t’u dëgjuar* përpara një gjykate kompetente.

12.1.3. *Parimit të paanshmërisë*, pasi në përbërje të trupave gjyqësore nuk kanë qenë gjyqtarë të paanshëm. Gjyqtarja R.B., që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë, për shkak të paragjyimit ka rrëzuar disa kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Për këtë arsye është kërkuar 4 herë përjashtimi i saj, por padrejtësisht kërkesat nuk janë pranuar. Gjithashtu, dhe në gjykatën e apelit dy gjyqtarët L.J. dhe Sh.M. nuk ofronin garanci objektive dhe subjektive, pasi kanë gjykuar disa çështje për të njëjtën mosmarrëveshje dhe të njëjtat palë. Konkretisht, gjyqtari L.J. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykatën e apelit që ka dhënë vendimin nr. 850, datë 12.07.2001, duke e cilësuar mosmarrëveshjen midis dy ortakëve me natyrë tregtare. Ndërsa Gjyqtari Sh.M. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykatën e apelit që ka dhënë vendimin penal nr. 1269, datë 01.07.2015 për shqyrtimin e procedimit penal, ku të akuzuar kanë qenë shtetasit Luan Leka dhe F.Gj. që kanë lidhje me çështjen civile në gjykim.

12.1.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe mosdiskriminimit*, pasi gjykata dhe administrata e ish-ZVRPP-së kanë ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, duke zvogëluar disa herë sipërfaqen e pronave. Pas proceseve gjyqësore diskriminuese dhe vendimeve arbitrare, sipërfaqja 740 m<sup>2</sup> e kërkuarit e përbërë nga 300 m<sup>2</sup> për secilin prej kateve, të 6-in dhe të 7-in, si dhe 140 m<sup>2</sup> në katin nëntokë, ka përfunduar me 0 m<sup>2</sup> në të dyja katet dhe 28.5 m<sup>2</sup> garazhin. Shtetasi Luan Leka nëpërmjet veprimeve të tij dhe regjistrimeve të paligjshme të ish-ZVRPP-së ka përfituar të drejta reale pronësore pa kontratë, të papërcaktuara në aktmarrëveshjen e datës 06.06.1995, pa shpërblim dhe pa disponim në vendimin nr. 10095, datë 03.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12.1.5. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi nuk është njoftuar për fillimin dhe mbarimin e veprimeve përbarimore të përbaruesit gjyqësor J.H. Gjykata e shkallës së parë njoftimin për ekzekutimin vullnetar e ka konsideruar si një akt me karakter njoftues dhe lajmërues dhe jo me karakter detyrues për palët. Ky arsyetim është në kundërshtim me të drejtat e njoftimit, pasi njoftimi është ndër veprimet më të rëndësishme përbarimore. Nëse nuk konfirmohet rregullshmëria dhe dijenia e debitorit për ekzekutimin vullnetar nuk mund të vijohet me veprimet e tjera dhe kryerja e tyre konsiderohet nul. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk mund t'i drejtohej asaj në datën 29.07.2013 për një veprim të ndodhur në datën 03.06.2011 është absurd. Edhe gjykata e apelit ka gabuar në arsyetimin e saj për mosnjoftimin e akteve të përbaruesit gjyqësor, duke e konsideruar të drejtë vendimin e shkallës së parë.

12.2. *E drejta e pronësisë*, pasi kërkuari është privuar nga kjo e drejtë, si pasojë e vendimeve të gjykatave dhe veprimeve arbitrare përbarimore. Ndërhyrja në të drejtën e pronësisë ka ndodhur si rezultat i vendimit gjyqësor me përmbajtje të pavërtetë, por edhe si rezultat i veprimeve arbitrare të ish-ZVRPP-së, Tiranë, të përbaruesit dhe të vetë shtetasit Luan Leka. Nëpërmjet transkriptimit nr. 97, datë 08.06.2011 për regjistrimin e vendimit nr. 10095, datë 03.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është hequr e drejta e pronësisë dhe janë regjistruar në pronësi të shtetasit Luan Leka të drejta reale përtej përmbajtjes së këtij vendimi. Vendimi për sigurimin e padisë të shtetasit Luan Leka nuk ekziston as në arkivën e vendimeve, as në dosjen përkatëse, duke u bllokuar kështu e gjithë veprimtaria e pallatit 9-katësh me sipërfaqe 2871 m<sup>2</sup>. Pasuritë

kanë qenë të krijuara përpara datës 06.06.1995 të marrëveshjes të lidhur mes palëve dhe duhet t'i ktheheshin kërkuarit.

12.3. *Legjitimiteti i palëve dhe dispozitat procedurale në lidhje me përfaqësimin*, pasi avokate F.Gj. nuk ka pasur tagra përfaqësimi për shtetasin Luan Leka. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim si të pabazuar duke iu referuar prokurës së lëshuar nga shtetasi Luan Leka. Gjykata ka gabuar në arsyetim, sepse prokura nuk përmban asnjë tagër përfaqësimi të shtetasit Luan Leka si ortak i shoqërisë “E.A.C” sh.p.k.

12.4. *Administrimi i provave kryesore dhe mënyra e parregullt e administrimit të tyre*, pasi vendimi është rrjedhojë e një gjykimi të padrejtë, ku spikasin veprimet e parregullta të gjykatës së faktit në lidhje me marrjen/mosmarrjen e provave kryesore të padisë, për të mundësuar rrëzimin apriori të padisë, pa arsyetuar kërkimet sipas objektit. Gjykata nuk ka administruar aktet përbërëse të njoftimit të regjistruarit F.H; mosnjoftimin e aktit të lajmërimit për ekzekutim vullnetar; urdhrin e ekzekutimit; vendimin për sigurimin e padisë; aktin “prapësime të kërkuarit”. Gjykata e Apelit nuk ka rimarrë provat e administruara në shkallë të parë dhe nuk ka marrë prova të reja.

12.5. *Paraqitja e pavërtetë e fakteve*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9055, datë 22.09.2014, ka pasqyruar gabim përmbajtjen e kërkesëpadisë në lidhje me cilësinë e palëve, duke hequr cilësinë “ortak” dhe “administrator” në objektin e padisë dhe duke ndryshuar bazën ligjore. Në titullin ekzekutiv, vendimi nr. 10095, datë 03.12.2009 i gjykatës së shkallës së parë, përmbajtja e aktmarrëveshjes së datës 06.06.1995 paraqitet në mënyrë të pavërtetë, jashtë objektit dhe mosmarrëveshjes. Marrëveshja nuk ka pasur për objekt godinën 7-katëshe, me kat nëntokësor, por ka si objekt vetëm një pjesë të kësaj godine. Objekti i saktë është shënuar në vendimin nr. 19, datë 25.04.2013 të Gjykatës. Vendimet e gjykatave janë të pabazuara kur arsyetojnë se shtetasi Luan Leka është pronar i ligjshëm, pasi nuk ka asnjë dokument që e bën të tillë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kolegji vlerëson se kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime dhe ka interes të drejtpërdrejtë.

15. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f” i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji vëren se kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi kompetencën për të shqyrtuar njërin prej kërtimeve të padisë e kishte gjykata administrative dhe jo ajo civile. Nga materialet e çështjes rezulton se kërkuuesi pretendimin nuk e ka ngritur në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit, por e ka parashtruar vetëm në rekurs, për rrjedhojë, për efekt të gjyimit kushtetues, kërkuuesi nuk i ka shteruar mjete juridike për këtë pretendim. Megjithatë, Kolegji vëren se në rastin konkret objekti i padisë ka qenë kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Në bazë të nenit 610 të KC-së, kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga kodi, palët mund të paraqesin ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit, për rrjedhojë gjykata civile ka qenë gjykata kompetente, e



përcaktuar me ligj, për shqyrtimin e çështjes dhe pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

17. Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtarët L.J. dhe Sh.M. të gjykatës së apelit. Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës rezulton se kërkuari nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim për përjashtimin e tyre, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Megjithatë, pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është analizuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka vlerësuar të pabazuar, pasi nuk rezulton që gjyqtarët pjesëmarrës në trupën gjyqësore të gjykatës së apelit të jenë shprehur për çështjen objekt gjykimi dhe as për rrethana që janë objekt shqyrtimi në këtë çështje (*shih pikën (i) në faqen 9 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këto arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

18. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Kolegji evidenton se kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në Gjykatën e Lartë dhe pasi ka parashtruar formalisht dhe në substancë pretendimet e tij, për rrjedhojë ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

19. Një ndër kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual është edhe ai i parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, i cili përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit.

20. Gjykata ka pohuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit, për qëllime të afatit ligjor 4-mujor, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në mjediset fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij (*shih vendimet nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se në rastet kur individi depoziton të dhënat e kontaktit elektronik, njoftimi individual në adresën elektronike është i detyrueshëm dhe ka përparësi në radhë për qëllime të vlerësimit të të drejtave procedurale të individit, përfshirë përlllogaritjen e afateve ligjore (*shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 06.03.2024, ndërsa kërkuari ka paraqitur kërkesën në Gjykatë në datën 19.09.2024, duke parashtruar se ka marrë dijeni për vendimin në

datën 23.05.2024, kur ka marrë një kopje të tij. Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Lartë rezulton se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 16.05.2024. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se në parashtrimet e depozituara nga mbrojtësi ligjor i kërkuarit janë lënë të dhënat elektronike të tij, por nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë njoftuar vendimin në adresën e postës elektronike. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se në çështjen konkrete si moment i konstatimit të cenimit do të konsiderohet data 23.05.2024, për rrjedhojë ankimi kushtetues i datës 19.09.2024 konsiderohet i paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

22. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuari ka parashtruar disa pretendime, më konkretisht se është cenuar e drejta e aksesit, parimi i paanshmërisë, barazia e armëve dhe mosdiskriminimi, e drejta për t'u mbrojtur, si dhe e drejta e pronësisë. Gjithashtu, ka parashtruar pretendime për legjitimitetin e palëve dhe dispozitat procedurale në lidhje me përfaqësimin e shtetasit Luan Leka gjatë procesit të themelimit, si dhe administrimin e provave dhe paraqitjen e pavërtetë të fakteve në vendimin e shkallës së parë dhe në vendimin për lëshimin e titullit ekzekutiv.

23. Fillimisht, Kolegji evidenton se për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit kërkuari ka parashtruar disa argumente. Një pjesë e argumenteve (i pari, i treti dhe i katërti) lidhet me gjykimin nga një gjykatë jokompetente, që, sikurse u analizua, është haptazi i pabazuar (*shih paragrafin 16 të vendimit*). Argumentet e tjera (i dyti dhe i pesti) për mospranimin e kërkesave paraprake, për shtimin e objektit të padisë dhe riçeljen e hetimit gjyqësor lidhen me vendime të ndërmjetme ose jopërfundimtare të marra nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe si të tilla nuk janë objekt shqyrtimi kushtetues sipas nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës. Për afatin 5-ditor të përcaktuar në dispozitivin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë (argument i gjashtë), Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues për të provuar cenimin e të drejtave kushtetuese. Për më tepër, nga përmbajtja e materialeve të çështjes rezulton se ndaj vendimit nr. 9055, datë 22.09.2014 të gjykatës së shkallës së parë kërkuari në datën 29.09.2014 ka paraqitur ankim, si dhe në datën 30.09.2014 shtesë ankimi, për rrjedhojë ai ka shfrytëzuar të gjitha mjetet procedurale për parashtrimin e pretendimeve të tij në gjykatën e apelit dhe nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues për cenimin e të drejtave të tij gjatë atij gjykimi. Për argumentin e fundit në drejtim të së drejtës së aksesit lidhur me zhvillimin e seancës në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit, Kolegji rithekson se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore me praninë e palëve u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka

arritur të argumentojë se vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit ka cenuar të drejtat e tij kushtetuese, për rrjedhojë pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, duke parashtruar se gjyqtarja R.B., që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë, për shkak të paragjyqimit ka rrëzuar kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Për këtë arsye është kërkuar 4 herë përjashtimi i saj, por padrejtësisht kërkesat nuk janë pranuar. Gjithashtu, dhe në gjykatën e apelit dy gjyqtarët L.J. dhe Sh.M. nuk kanë ofruar garanci objektive dhe subjektive, pasi kanë gjykuar disa çështje për të njëjtën mosmarrëveshje dhe të njëjtat palë. Konkretisht, gjyqtari L.J. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykatën e apelit që ka dhënë vendimin nr. 850, datë 12.07.2001, duke e cilësuar mosmarrëveshjen midis dy ortakëve me natyrë tregtare. Ndërsa gjyqtari Sh.M. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykatën e apelit që ka dhënë vendimin penal nr. 1269, datë 01.07.2015 për shqyrtimin e procedimit penal ku të akuzuar kanë qenë shtetasit Luan Leka dhe F.Gj. që kanë lidhje me çështjen civile në gjykim.

25. Kolegji vlerëson se për cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në shkallë të parë vetëm fakti se gjykata nuk ka pranuar kërkesat paraprake të kërkuesit nuk është argument në nivel kushtetues për të provuar cenimin e paanshmërisë gjatë gjykimit. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për shqyrtimin e çështjes rezulton se 4 kërkesat e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarës R.B. janë shqyrtuar nga gjykata dhe me vendimet e datës 13.12.2013, 20.03.2014 dhe 03.06.2014 është vendosur respektivisht pushimi i gjykimit, pasi kërkuesi në dy raste ka hequr dorë nga shqyrtimi i kërkesës për përjashtimin, kurse në rastin e tretë nuk është paraqitur në seancë pa shkak. Ndërsa me vendimin e datës 08.09.2014 gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës, si të pabazuar në ligj e në prova, duke arsyetuar se referuar pretendimeve të kërkuesit, që kanë të bëjnë me mospranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit gjyqësor, gjyqtarja në asnjë rast nuk ka shfaqur arsye serioze njëanshmërie, por ka zbatuar ligjin, nenin 304 të KPC-së. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues në drejtim të cenimit të parimit të paanshmërisë.

26. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve e mosdiskriminimit dhe të së drejtës së pronësisë, Kolegji konstaton se kërkuesi ka parashtruar të njëjtat argumente, konkretisht se si rezultat i proceseve gjyqësore dhe veprimeve arbitrare të administratës së ZVRPP-së atij i është cenuar e drejta e pronësisë. Pretendimet lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes, i cili ka përfunduar në vitin 2011. Procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues individual konkret lidhet me kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera pasi vendimi gjyqësor për themelin e çështjes ka marrë formë të prerë. Kërkuesi

pretendimin e tij e ka parashtruar gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme, të cilat kanë arsyetuar se për çdo pretendim për cenimin e së drejtës së pronësisë si rezultat i veprimeve të administratës, kërkuesi mund t'u drejtohet gjykatave me një padi të re. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuetit është haptazi i pabazuar.

27. Për pretendimet e tjera lidhura me legjitimitetin e palëve, zbatimin e dispozitave procedurale për përfaqësimin e palës së paditur gjatë gjykimit të themelit të çështjes, administrimin e provave, paraqitjen e pavërtetë të fakteve, si dhe vlerësimin e provave, Kolegji, bazuar në jurisprudencën kushtetuese dhe në shkronjën “dh”, pika 2, të nenit 31/a të ligjin nr. 8577/2000, thekson se kur Gjykata është shprehur më parë me vendim për themelin e pretendimeve të ngritura, në situatën e riparimit të kërkesës, ajo ka vlerësuar se vendimi i mëparshëm përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që është mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me shkaqet të ngritura në kërkesë (*shih vendimin nr.60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet e sipërcituara lidhen me procesin gjyqësor të themelit të çështjes civile, të cilat janë shqyrtuar më parë nga Gjykata dhe me vendimin nr. 19, datë 25.04.2013 janë vlerësuar si të pabazuara. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

28. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, nisur nga thelbi i argumenteve, sipas të cilave mosnjohimi i aktit të përmbartuesit gjyqësor për ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë ka cenuar efektivitetin e së drejtës së ankimit në gjykatë dhe se gjykatat kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin, do të analizohet në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*

29. Kërkuesi ka pretenduar se mosnjohimi i akteve të përmbartuesit përbën shkelje të rëndë të KPC-së. Nëse përmbartuesi nuk njofton për veprimet e kryera, e drejta e ankimit nuk është efektive, pasi veprimet do të kenë përfunduar. Gjykata e shkallës së parë njoftimin për ekzekutimin vullnetar e ka konsideruar si një akt me karakter njoftues dhe lajmërues dhe jo me karakter detyrues për palët në proces. Ky arsyetim është në kundërshtim me të drejtat e njoftimit, pasi njoftimi për ekzekutimin vullnetar është ndër veprimet më të rëndësishme përmbartimore, pasi nëse nuk konfirmohet rregullshmëria dhe dijenia e debitorit për ekzekutimin vullnetar nuk mund të vijohet me veprimet e tjera dhe kryerja e tyre konsiderohet nul. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk mund t'i drejtohej asaj në datën 29.07.2013 për një veprim të ndodhur në datën 03.06.2011, është absurd.

30. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Nga materialet e dosjes së administruar për qëllim të shqyrtimit të çështjes rezulton se procesi ka nisur në datën 29.07.2013, pas padisë së kërkuarit për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore të përmbartuesit gjyqësor J.A., për të cilat ka pretenduar se ka marrë dijeni me shkresën e datës 22.07.2013 të ZVRPP-së, Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9055, datë 22.09.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kjo gjykatë për kërkimin e kërkuarit për pavlefshmërinë e aktit nr. 3782 prot., datë 03.06.2011 të përmbartuesit gjyqësor

për lajmërimin për ekzekutimin vullnetar ka arsyetuar se ky akt është thjesht një vendim procedural me karakter njoftues dhe lajmërues dhe nuk ka natyrë të mirëfilltë të veprimeve përmbartimore me karakter detyrues për palët në proces. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka çmuar se kërkuesi nuk mund t'i drejtohet gjykatës me padi në vitin 2013 për të kundërshtuar një veprim përmbartimor të ndodhur në vitin 2011. Sipas gjykatës së shkallës së parë shoqëria përmbartimore, me vendimin nr. 4060 prot., datë 17.06.2011, ka vendosur pushimin e ekzekutimit, pasi vendimi është ekzekutuar plotësisht dhe dosja përmbartimore është arkivuar (*shih faqet 5-6 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 405, datë 30.05.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

34. Pas rekursit të kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-926, datë 06.03.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 472 të KPC-së. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit (faza e seleksionit) rezulton se u është dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në recurs, si për realizimin e së drejtës së mbrojtjes, për të drejtën e pronësisë të fituar me vendim të formës së prerë nga shtetasi Luan Leka dhe për zbatimin e dispozitave materiale e procedurale nga përmbartuesi gjyqësor. Për pretendimin thelbësor për mosnjoftimin e aktit për ekzekutimin vullnetar të vendimit, Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se nuk janë cenuar të drejtat e kërkuesit/paditësit, pasi njoftimi i jep mundësi atij për të ekzekutuar një vendim gjyqësor vullnetarisht dhe nuk krijon efekte detyruese (*shih pikën (iii) të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë ndonjë gabim të dukshëm ligjor ose faktik në lidhje me zbatimin e ligjit material dhe procedural, të tillë që ta bënte gjykimin të padrejtë, për rrjedhojë pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

35. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.